

## VENDIMET E BORDIT TË DATËS 29 JANAR 2019

Në mbledhjen e Bordit Ekzekutiv të Federatës të mbajtur më 29 janar 2019, me shumicë votash të anëtarëve u morën këto vendime:

### Vendimi Nr. 2019-01

#### *Development Workshop / Kuvendi Vjetor 2019 i Federatës Evropiane të Tenisit*

- Kryesuesi i Këshillit Profesional, z. Shkëlzen Domi, të merr pjesë në Tennis Europe Development Workshop 2019, që do të mbahet në mars 2019 në Maltë.
- Kryetari Rexhepi do ta përfaqësojë Federatën në Kuvendin Vjetor të Tennis Europe që mbahet në mars 2019 në Maltë.

### Vendimi Nr. 2019-02

#### *ITF/TE Development Championships 2019 – Antali, Turqi*

- Të njoftohen selektorët U12/U14 se kanë opcionin që me shpenzime të Federatës të mbajnë turne selektues në formatin Round Robin - me katër të parët në ranglistat e grupmoshave përkatëse - për t'i përzgjedhur tenistët që kualifikohen në kampet dhe turnetë në Antali;
- Selektorët në fuqi në fillim të vitit, Argjend Lecaj U14 dhe Lorik Haxhishabani U12, do të shoqërojnë ekipet e tyre përkatëse;
- Si trajnere ndihmëse për kampin U12, e që nga Tennis Europe është vend i rezervuar për trajnere femër, Bordi e përcakton znj. Blearta Ukëhaxhaj.

### Vendimi Nr. 2019-03

#### *Certifikimi për ITF Level I gjatë 2019*

- Federata në bashkëpunim me ITF gjatë vitit 2019 të organizojë mbajtjen e seancave certifikuese për ITF Level I (diku 7-8 fundjavë);
- Pritet që numri i trajnerëve që synojnë certifikimin të jetë 10-20 persona;
- Pjesëmarrësit duhet të mbulojnë 50% të kostos për vijimin e kursit dhe provimeve.

### Vendimi Nr. 2019-04

#### *Kalendari i garave për vitin 2019*

- Miratohet në parim Kalendari Zyrtar i garave për vitin 2019, i punuar nga Këshilli Profesional, dhe i njëjti të publikohet në uebfaqen zyrtare.
- Për çfarëdo ndryshimi në data nevojitet pëlqimi paraprak i Federatës.
- Klubet detyrohen ta njoftojnë Federatën së paku një (1) muaj më herët për anulimin e një turneu, në të kundërtën për 1 vit e humbin të drejtën e përkrahjes nga Federata me rekuizita, aktivitete apo përfshirje në aktivitete të ndryshme. Përgjashtim bëjnë rastet kur për shkak të motit të keq mbikëqyrësi i turneut vlerëson se nuk ka kushte për mbajtjen e turneut.

### Vendimi Nr. 2019-05

#### *Pjesëmarrja në turnetë zyrtare të Federatës – Kotizimi / Paraqitja / Shorti*

- Pas shqyrtimit të kërkesës së klubeve për t'i rritur disa prej kotizimeve, merret vendimi për kotizimet për pjesëmarrje në turnetë zyrtare të Federatës prej tash e tutje të jenë:
  - ROG 5 EUR
  - U12 10 EUR
  - U14 10 EUR
  - U16 10 EUR
  - U18 10 EUR
  - Senior 15 EUR
  - Veteran 20 EUR
- Afati i fundit për paraqitjen e lojtarëve në turne është në orën 17:00, dy (2) ditë para datës së paraparë për fillimin e turneut. Kjo vlen për të gjitha grup-moshat.
- Klubi (organizatori) obligohet që më së largu deri në orën 18:00 ta dërgojë në Federatë dhe të mbikëqyrësi listën e lojtarëve të paraqitur (Emri, Mbiemri, data e lindjes, shtetësia dhe kategoria).
- Shorti duhet të hedhet dhe publikohet deri në orën 18:00 në ditën para fillimit të turneut, ndërkaq orari i meçeve në orën 21:00 të ditës paraprake.

### Vendimi Nr. 2019-06

#### *Finalizimi i rregullores për shpërblimet*

- Grupi punues që do të finalizojë hartimin e rregullores për shpërblime përbëhet nga tre anëtarët: (1) Gëzim Mehmeti; (2) Mërgime Mula; dhe (3) Blerim Koro.
- Rregullorja duhet shqyrtuar propozimet e Komisionit për Shpërblime të dhjetorit 2018.

### Vendimi Nr. 2019-07

#### *Përzgjedhja e selektorëve*

- Miratohen propozimet në vijim të Këshillit Profesional për selektorët:
  - U12 (M/F) – Lorik Haxhishabani (vazhdon)
  - U14 (M/F) – Arian Ibrahim (nga 1 prill 2019)
  - U16 (M/F) – Granit Bajraliu (nga 1 shkurt 2019)
  - Senior (F) – Arben Islami (vazhdon)
- Pozita e selektorit për Senior (M), ndryshe Davis Cup, ngel e zbrazët deri në shqyrtimin e mundësive të reja.

### Vendimi Nr. 2019-08

#### *Pasqyrat e Audituarra Financiare*

- Miratohen pasqyrat e audituarra financiare për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2018.
- Të njëjtat të publikohen në uebfaqen zyrtare.

